



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr/Br. 516/17
Datë/Datum. 12.02.18

PRISHTINE - PRIŠTINA

PSH. nr. 516/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Petrol Company” – Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me derivate për nevojat e RTK-së”, me nr. prokurimi: 17/5223/125, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Radio Televizioni i Kosovës (RTK), më datë: 25 janar 2018, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Petrol Company” – Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me derivate për nevojat e RTK-së”, me nr. prokurimi: 17/5223/125, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Radio Televizioni i Kosovës (RTK).

II. VËRTETOHET, vendimi për dhënie të kontrates i AK-së- Radio Televizioni i Kosovës (RTK), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me derivate për nevojat e RTK-së”, me nr. prokurimi: 17/5223/125.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Petrol Company” – Fushë Kosovë, refuzohet si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 19. 10. 2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 02. 11. 2017, njoftimi për dhënien e kontratës nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 07. 12. 2017.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Petrol Company” – Fushë Kosovë, me dt: 11. 12. 2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues. Me dt: 12. 12. 2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Petrol Company” – Fushë Kosovë.

Operatori ekonomik ankues “Petrol Company” – Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me 18 dhjetor 2017, me nr. 516/17, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Furnizimi me derivate për nevojat e RTK”, me nr.prokurimi: RTK- 17-723-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Radio Televizioni i Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 58, 59 të LPP-së, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenin 37. 2, 18 të UOPP-së, si dhe nenin 20 të dosjes së tenderit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 22. 12. 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 03. 01. 2018, në lidhje me pretendimet ankimore të OE "Petrol Company"- Fushë Kosovë ka rekomanduar që të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës i datës 07 dhjetor 2017 ndërsa ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

Autoriteti Kontraktues – RTK, me datë: 04. 01. 2018, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertës shqyrtues dhe ka kërkuar që të vazhdohet me mbajtjen e seancës për shqyrtim kryesor.

Operatori ekonomik ankues "Petrol Company" – Fushë Kosovë, me datë: 08 janar 2018, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 25. 01. 2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues deklaroi: "Ne jemi deklaruar në dy pika kryesore, njëra se OE i rekomanduar për kontratë në listën e çmimeve dhe nuk ka dhënë premiumin për litër por ka dhënë çmim për litër, ndërsa premiumin ka dhënë në aneksin 8 të lista e çmimeve ku tregohet se si duhet të kalkulohet çmimi. Çështja e dytë është se OE i rekomanduar për kontratë ka më shumë se dy decimale të premiumit të dhëna në ofertë ku neni 20 parasheh se çdo numër duhet të ketë dy decimale pas presjes dhjetore. Duhet të cek se premiumi i dhënë nga OE fitues në aneks 8, ajo listë nuk është e nënshkruar prej OE-ve siç e parasheh ligji në momentin e hapjes së ofertave. Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe kërkojmë nga paneli shqyrtues të detyroj AK-në të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK- RTK deklaroi: "Edhe në shkresën e dërguar kemi pasur pajtim të pjesshëm me ekspertin, pasi që eksperti ka konstatuar vetëm një lëshim nga AK, konkretisht të kjo pikë nuk jemi pajtuar me ekspertin për arsye se jemi bazuar në UOPP faqe 25 ku çdo numër pas dy zerove nuk merret për bazë dhe mund të shkohet tutje. Gjithashtu ne kërkojmë sipas nenit 112 par 2 që

interesi është shumë më i madh pasi që në një periudhë të gjatë jemi pa derivate dhe tani rrezikohet edhe transmetimi ngase nuk kemi derivate as për gjenerator. Gjithnjë duke vlerësuar se eksperti ka bërë lëshim dhe në këtë çështje e kemi trajtuar sipas UOPP me detaje të cekura në shkresë. OE fitues thotë se në tabelën e çmimeve ka përfshirë premiumin dhe kjo gjendet në dosjen e tenderit”.

Anëtari i panelit z. Dina pyeti përfaqësuesin e AK-së në mënyrën si ka dhënë çmimin OE i rekomanduar për kontratë, a do të kemi problem në implementimin e kontratës?, në përgjigje i njëjti deklaroi: “Jo nuk do të ketë probleme pasi është e qartë çmimi i OE të rekomanduar për kontratë”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE deklaroi: “Aneksi 8 tabela për llogaritjen e çmimit kushtues, kjo është indikacion që tregon si do të kalkulohet çmimi kushtues dhe nuk duhet të plotësohet nga ana e OE. OE e ka pasur si obligim që çmimin ta jep të përshkrimi i çmimit e je te tabela që tregon se si do të kalkulohet çmimi. I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim, dhe të pranoj ofertën e OE “Petrol Company” si të përgjegjshme sipas kushteve të dosjes së tenderit me dy decimale pas presjes dhjetore”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroi: “Sipas UOPP dhe nenit 112. 2 kërkojmë nga OSHP duke u bazuar gjithnjë në ruajtjen e buxhetit i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së duke pasur parasysh edhe rrethanat e cekura si më lartë, njëkohësisht të refuzohet ankesa e OE ankues”.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstatoj se OE i rekomanduar për kontratë në formularin e dorëzimit të tenderit ka dhënë çmimin total të ofertës, në aneksin 8 “tabela për llogaritjen e çmimit kushtues” OE i rekomanduar ka dhënë çmimin e premiumit dhe tek pjesa përshkrimi i çmimeve ka cekur qartë çmimin e premiumit për secilin artikull.

Paneli shqyrtues konstaton OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar më shumë se dy numra pas presjes dhjetore në ofertën e tij, mirëpo sipas nenit 18. 3 të UOPP “Çmimi i ofertuar lejohet të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës”. Paneli shqyrtues konstaton se ofertimi me më shumë se dy decimale pas pikës dhjetore. nuk e bën të papërgjegjshëm OE të rekomanduar për kontratë, por numrat me më shumë se dy decimale pas presjes dhjetore nuk merren për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Gjithashtu

edhe përfaqësuesi i AK-së në seancën dëgjimore sqaroj se mënyra e dhënë e çmimit nga OE i rekomanduar për kontratë nuk paraqet problem në implementim të kontratës.

Paneli shqyrtues poashtu konstaton se është i paqëndrueshëm pretendimi ankimor i OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 58. 3 të LPP-së dhe nenit 37. 2 i UOPP ku përcaktohet se: “ Në çdo rast secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër”, pasi që OE i rekomanduar për kontratë “Hib Petrol” ka plotësuar dhe dorëzuar formularin e dorëzimit të tenderit ku edhe ka dhënë çmimin për litër ku për faktin se kriteri është çmimi më i ulët i premiumit dhe si rrjedhojë e kësaj në bazë të çmimit të ofruar nuk dihet çmimi i premiumit, pasi që para se të shtypet dhe nënshkruhet procesverbali i hapjes së ofertave nga AK, përfaqësuesit e OE ankues kanë qenë prezent kanë mundur të paraqesin vërejtje, mirëpo një gjë të tillë nuk e kanë bërë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - “Radio Televizioni i Kosovës”

1x1 OE - “Petrol Company” – Fushë Kosovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.